



Pranimar / Dorezuar Prilapim / Prilapim Received / Delivery	18.01.2023	3	viti god year
Organi / Njesia Organ / Jedinica Org / Unit	Nr Prot Br Prot Prot No	Shtojca Prilog Appendix	Sasia Kolicina Quantity
SKANSHTOR	491/2023		117



Republika e Kosovës
Republika Kosova – Republic of Kosovo

KËSHILLI I PAVARUR MBIKËQYRËS PËR SHËRBIMIN CIVIL TË KOSOVËS
NEZAVISNI NADZORNI ODBOR CIVILNE SLUŽBE KOSOVA
INDEPENDENT OVERSIGHT BOARD FOR THE CIVIL SERVICE OF KOSOVO

A.nr.1103/2022

Këshilli i Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës- Kolegji për Shqyrtimin dhe Vendosjen e Ankesave i përbërë nga: Eshref Shabani-kryetar, Jeton Koca dhe Ardita Haxhnikaj-Demi-anëtarë, me Flakron Gashi-Zyrtar i Lartë për Bashkëpunim Profesional, në cilësinë e procesmbaitësit, ka shqyrtuar ankesën me numër A.nr.1103/2022, të datës 05.12.2022 të ankuesit _____, me adrese banimi: Fshat _____, rruga _____ P.N, Komuna e Gjakovës, kundër Vendimit KA.nr.34/22 të Komisionit për Zgjidhjen e Kontesteve dhe Ankesave të Këshillit Prokurorial të Kosovës i datës 07.11.2022, në çështjen juridike "kontestim konkursi", duke vepruar në pajtim me nenin 6 paragrafin 1 nën paragrafin 1.1 dhe nenin 18 paragrafin 1 nën paragrafin dhe 1.1 të Ligjit Nr. 06/L-048 për Këshillin e Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës, dhe Rregulloren Nr.02/2018 për Procedurën e Shqyrtimit dhe Vendosjes së Ankesave në Këshillin e Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës, në seancën për këshillim dhe votim, me datë 18.01.2023, mori :

V E N D I M

- I. Refuzohet si e pabazuar ankesa me numër A.nr.1103/2022 e datës 05.12.2022 e parashtruar nga ankuesi
- II. Mbetet në fuqi Vendimi KA.nr.34/22 i Komisionit për Zgjidhjen e Kontesteve dhe Ankesave i Këshillit Prokurorial të Kosovës i datës 07.11.2022.

A r s y e t i m

Ankuesi, _____ i cili sipas shkresave të lëndës është kandidat në procedurën e rekrutimit të shpallur me datë 22.08.2022 nga Sekretarit i Këshillit Prokurorial i Kosovës, për pozitën Zyrtar Ligjor 2" në Prokurorinë Themelore në Gjakovë, me datë 02.12.2022 nëpërmjet a postë ka parashtruar ankesë, e cila në Këshillin e Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës është pranuar me datë 05.12.2022 dhe është protokolluar me numër 7642/2022, kundër Vendimit KA.nr.34/22 të Komisionit për Zgjidhjen e Kontesteve dhe Ankesave i datës 07.11.2022.

Ankuesi në ankesën e parashtruar në Këshilli pretendon se procedura e rekrutimit është zhvilluar në kundërshtim me dispozitat ligjore të Ligjit Nr.03/L-149 për Shërbimin Civil të Kosovës dhe Rregullores Nr.02/2010 për Procedurat e Rekrutimit në Shërbimin Civil, pasi Komisioni Përzgjedhës është themeluar në kundërshtim me dispozitat e nenit 7 paragrafi 1 të rregullores, kandidatja e përzgjedhur ka qenë praktikante në këtë institucion dhe e njëjta nuk i ka përmbushur kriteret e konkursit respektivisht përvojën e punës, institucionin nuk e ka njoftuar Këshillin lidhur me procedurat e rekrutimit për pozitën udhëheqëse si dhe vlerësimi i përgjigjeve të dhëna në testin me shkrim dhe intervistë nuk ka qenë objektiv.

Këshilli i Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës (me tej KPMSHCK) bazuar në dispozitat e Rregullores Nr.02/2018 për Procedurën e Shqyrtimit dhe Vendosjes së Ankesave, ka proceduar kërkesën për përgjigje në ankesë të Këshilli Prokurorial i Kosovës. Ndërsa me datë 28.12.2022, KPMSHCK-ja ka pranuar përgjigjen në ankesë se bashku me shkresat lidhur me çështjen në procedurë.

Kolegji për Shqyrtimin dhe Vendosjen e Ankesave, për vendosje meritore, ka administruar këto prova: Ankesën e datës 05.12.2022 e parashtruar nga ankuesi në Këshillin e Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës; Vendimi i lëshuar nga Komisioni për zgjedhjen e kontesteve dhe ankesave ka.Nr.34/2022 i datës 07.11.2022; Konkurs me referencë KPK/SKPK/ZKPSH/PA/PSRK/PTH/POZ-015; Njoftimi për kandidatët e zgjedhur në listën e ngushtë i datës 12.09.2022; Njoftim për përzgjedhjen përfundimtare i Këshillit Prokurorial i datës 06.10.2022; Përgjigja në ankesë me numër të protokollit 8501/2022 e datës 28.12.2022; Regjistri i aplikacioneve të pranuar; Raporti lidhur me listën e ngushtë për pozitën Zyrtar Ligjor 2/PTH Gjakovë e datës 12.09.2022; Përcaktimi i kriterëve për përfshirjen në listën e ngushtë e datës 12.09.2022, Lista përfundimtare e përzgjedhjes së listës së ngushtë e datës 12.09.2022; Vlerësimet individuale për listën e ngushtë nga . i datës 12.09.2022; Vlerësimet individuale për listën e ngushtë nga . i datës 12.09.2022; Vlerësimet individuale për listën e ngushtë nga . i datës 12.09.2022; Vlerësimet individuale për listën e ngushtë nga . i datës 12.09.2022; Vlerësimet individuale për listën e ngushtë nga . i datës 12.09.2022; Përmbledhja e vlerësimeve individuale të listës së ngushtë e datës 12.09.2022; Deklaratë për mosekzistimin e konfliktit të interesit për . i datës 12.09.2022; Deklaratë për mosekzistimin e konfliktit të interesit për . i datës 12.09.2022; Deklaratë për mosekzistimin e konfliktit të interesit për . i datës 12.09.2022; Deklaratë për mosekzistimin e konfliktit të interesit për . i datës 12.09.2022; Deklaratë për mosekzistimin e konfliktit të interesit për . datës 12.09.2022; Vendim DPSKPK/Nr.415/2022 i datës 08.09.2022; Vendim DPSKPK/Nr.409/2022 i datës 06.09.2022; Akt emërim për . i datës 03.01.2018; Akt emërim për . i datës 27.07.2018; Ndryshimi dhe plotësimi i akt emërimit për . i datës 11.03.2022; Ndryshimi dhe plotësimi i akt emërimit për . i datës 01.03.2022; Akt emërim për . i datës 13.05.2015; Dëshmi për dorëzimin e aplikacionit nga V.D me numër 1350 i datës 05.09.2022; Aplikacioni për punësim i . ; CV e kandidatit . Letër motivimi; Diplomë e lëshuar nga Universiteti i Pejës "Haxhi Zeka" për V.M me numër 83, i datës 14.10.2020; Diplomë e lëshuar nga Universiteti i Pejës "Haxhi Zeka" për . me numër 643, i datës 05.10.2018; Certifikatë e lëshuar nga Gjykata Themelore në Gjakovë .nr.43/2020 për . e datës 24.02.2020; Certifikatë e lëshuar nga Gjykata Themelore në Gjakovë me numër PN.NR/KR.Br 3399/2022 i datës 05.05.2022; Certifikatë e lëshuar nga LoOndon School of English për . ; Certifikatë e lëshuar nga English Profesional School për . , Certifikatë e lëshuar nga London Language

Center Gjakovë për me numër 01; Certifikatë e lëshuar nga London Language Center Gjakovë për me numër 03; Kopje e letërnjoftimit të ankuesit; Certifikatë pjesëmarrje e lëshuar nga NCSC për Letër konfirmimi për praktikë e lëshuar nga NCSC e datës 29.09.2020; letër reference e datës 25.09.2019; Letër rekomandimi për e datës 04.10.2021; Letër rekomandimi për e datës 04.10.2021; Letër rekomandimi e lëshuar për e datës 09.06.2020; Certifikatë e lëshuar nga USAID për , Dëshmi për dorëzimin e aplikacionit për e datës 07.09.2022; Aplikacioni për D.B i datës 05.09.2022; Diplomë e lëshuar nga BPRAL-PPoHE Kolegji AAB me numër 1715/21 i datës 31.08.2021; Letër Reference E LËSHUAR nga Prokuroria Themelore në Gjakovë për p.nr.42/2022 i datës 01.09.2022; Kontratë për punë praktike vullnetare e lëshuar nga Këshilli Prokurorial, me numër 37/2021; Deklaratë për konfidencialitet për ; Letër reference e lëshuar për e datës 01.09.2022; Vërtetim i lëshuar nga Avokaturë & Konsulencë Financiare për D.B e datës 25.08.2022; Vërtetim i lëshuar nga Prokuroria Themelore në Gjakovë për me numër AP.nr.128/2018, e datës 24.09.2018; Referencë e lëshuar për e datës 18.10.2021; Kopje e letërnjoftimit për Certifikatë e lëshuar nga Gjykata Themelore në Gjakovë PN.NR/KR.Br.7858/2022 e datës 25.08.2022; Kopje e plikos R 2481704; Deklaratë për mosekzistim të konfliktit të interesit e e datës 16.09.2022; Testim me shkrim për i datës 16.09.2022 prej 1 deri 11 faqe; Deklaratë për mosekzistim të konfliktit të interesit e e datës 16.09.2022; Testi me shkrim i e datës 16.09.2022 prej 1 deri 11 faqe; Formularët e Vlerësimit Individual në Intervistë me gojë e datës 23.09.2022; Formularët e Vlerësimit individual përfundimtarë për vendin e punës për të cilin nuk kërkohet njohja e ndonjë gjuhe të huaj për i datës 29.09.2022; Formularët e Vlerësimit individual përfundimtarë për vendin e punës për të cilin nuk kërkohet njohja e ndonjë gjuhe të huaj për i datës 29.09.2022; Formularët e Vlerësimit individual përfundimtarë për vendin e punës për të cilin nuk kërkohet njohja e ndonjë gjuhe të huaj për i datës 29.09.2022; Formularët e Vlerësimit individual përfundimtarë për vendin e punës për të cilin nuk kërkohet njohja e ndonjë gjuhe të huaj për i datës 29.09.2022; Formularët e Vlerësimit individual përfundimtarë për vendin e punës për të cilin nuk kërkohet njohja e ndonjë gjuhe të huaj për i datës 29.09.2022; Formularët e Vlerësimit individual përfundimtarë për vendin e punës për të cilin nuk kërkohet njohja e ndonjë gjuhe të huaj për i datës 29.09.2022; Formularët e Vlerësimit individual përfundimtarë për vendin e punës për të cilin nuk kërkohet njohja e ndonjë gjuhe të huaj për i datës 29.09.2022; Formularët e Vlerësimit individual përfundimtarë për vendin e punës për të cilin nuk kërkohet njohja e ndonjë gjuhe të huaj për i datës 29.09.2022; Formularët e Vlerësimit individual përfundimtarë për vendin e punës për të cilin nuk kërkohet njohja e ndonjë gjuhe të huaj për i datës 29.09.2022; Formularët e Vlerësimit individual përfundimtarë për vendin e punës për të cilin nuk kërkohet njohja e ndonjë gjuhe të huaj për i datës 29.09.2022; Formularët e Vlerësimit individual përfundimtarë për vendin e punës për të cilin nuk kërkohet njohja e ndonjë gjuhe të huaj për i datës 29.09.2022; Formularët e Vlerësimit individual përfundimtarë për vendin e punës për të cilin nuk kërkohet njohja e ndonjë gjuhe të huaj për i datës 29.09.2022; Formularët e Vlerësimit individual përfundimtarë për vendin e punës për të cilin nuk kërkohet njohja e ndonjë gjuhe të huaj për i datës 29.09.2022; Renditja përfundimtare e kandidatëve e datës 30.09.2022; Përmbledhje e vlerësimeve individuale e intervistës e datës 30.09.2022; Përmbledhje e vlerësimeve individuale e testit me shkrim dhe intervistës e datës 30.09.2022; Përcaktimi i kriterëve për testimin me shkrim dhe me gojë për vendim e punës e datës 16.09.2022; Lista përfundimtare e

përzgjedhjes të testit me shkrim e datës 20.09.2022; Përmbledhje e vlerësimeve të testit me shkrim; Përmbledhje e vlerësimeve individuale e testit me shkrim e datës 20.09.2022; Njoftim për përzgjedhjen përfundimtare e lëshuar nga Këshilli Prokurorial e datës 06.10.2022; Rekomandim për emërim i datës 30.09.2022; Raporti final i rekomandimit nga komisioni rekrutues i datës 30.09.2022; Vendim i Komisionit për zgjedhjen e kontesteve dhe ankesave KA.Nr.34/2022 e datës 07.11.2022; Ankesë nga ankuesi datës 26.10.2022; Njoftim i kandidatëve të përzgjedhur në listën e ngushtë i datës 12.09.2022; Pliko e bardhë e datës 28.12.2022.

Kolegji për Shqyrtimin dhe Vendosjen e Ankesave, pas shqyrtimit të gjitha shkresave të lëndës të parashtruara nga palët në procedurë, ka konstatuar se ankesa e ankuesit _____, është e bazuar, SEPSE:

Kolegji për Shqyrtimin dhe Vendosjen e Ankesave, nga administrimi i shkresave të lëndës ka gjetur se Këshilli Prokurorial i Kosovës me datë 20.08.2022 ka hapur konkursin për pozitën e punës "Zyrtar Ligjor 2"-një (1) pozitë në Prokurorinë e Themelore të Gjakovës, ndërsa kriteret të konkursit për vendin e kërkuara të punës kanë qenë: *Përgatitja profesionale dhe kualifikimi: Diplomë Universitare, Fakulteti Juridik dhe Përvoja e Punës- Një (1) vit përvojë të punës profesionale*, ndërsa nga shkresat e lëndës është konstatuar fakti se ankuesi ka qenë kandidat në këtë procedurë i cili i është nënshtruar testit me shkrim dhe intervistat me gojë, mirëpo nuk ka rezultuar të jetët kandidatë i suksesshëm sipas Njoftimit për përzgjedhjen përfundimtare të datës 06.10.2022.

Ankuesi i pakënaqur me vlerësimin përfundimtar të Komisionit të Pranimit kishte parashtruar ankesë në Komisionin për Zgjidhjen e Kontesteve dhe të Ankesave, ndërsa Komisioni për Zgjidhjen e Kontesteve dhe të Ankesave me datë 07.11.2022 ka nxjerrë vendimin KA.nr.34/2022 duke e refuzuar ankesën e ankuesit 26.10.2022 si të pabazuar, ndërsa e kishte lënë në fuqi Njoftimin e Sekretarit të Këshillit Prokurorial të Kosovës të datës 06.10.2022 lidhur më përzgjedhjen përfundimtare të kandidatit të suksesshëm.

Nga shkresat e administruara të lëndës, Kolegji i këshillit ka konstatuar se Sekretarit i Këshillit Prokurorial të Kosovës përmes Vendimit të datës 08.09.2022 më numër:1509/2022 të nxjerrë nga U.D i Drejtorit të Përgjithshëm ka themeluar Komisionin Përzgjedhës të Shërbimit Civil në përbërje prej pesë (5) anëtarësh nga pozitat si në vijim: 1. Administrator i Prokurorisë, PSRK-kryesues; 2. Zyrtar i Lartë për Integrim Evropian, SKPK-anëtar; 3. Bashkëpunëtor Profesional-Prokuroria Themelore në Gjakovë-anëtar; 4. Bashkëpunëtor Profesional-Prokuroria Themelore në Prizren-anëtar; dhe 5. Zyrtare Ligjore, Prokuroria Speciale e Republikës së Kosovës-anëtare, veprim ky në pajtueshmëri me dispozitat e Rregullores Nr.02/2010 për Procedurat e Rekrutimit në Shërbimin Civil neni 7 paragrafi ku përcaktohet se: "Institucionet themelojnë një komision përzgjedhës ad-hoc të shërbimit civil (në tekstin në vijim: KPSHC), i cili zhvillon procedurat e rekrutimit. KPSHC përbëhet nga anëtarët të cilët kanë pozita më të lartë se pozitat që duhet të rekrutohet, por një anëtar mund të ketë pozitën e njëjtë, të jetë shumë etnik dhe përfaqësim gjinor. KPSHC zhvillon procedurat e rekrutimit për pozitat e karrierës dhe të jo karrierës.", ngase sipas aktit të emërimit të datës 03.01.2018 dhe atij të datës 27.07.2018, sikurse Ndryshimit dhe Plotësimit të akteve të emërimit të datës 11.03.2022 dhe atij të datës 01.03.2022 si dhe Aktit të emërimit të datës 13.05.2015, katër (4) anëtarët e parë sipas renditjes kanë pozita më ta larta sesa pozita që rekrutohet ndërsa, pozita e anëtares së pestë është pozitë ekuivalente me pozitën që

rekrutohet, sikurse komisioni i themeluar ka përmbushur edhe kriterin gjinor dhe etnik, nga rrjedh se pretendimi ankimor i ankuesit ndërlidhur me themelimin e Komisionit Përzgjedhës nuk është i bazuar.

Kolegji i Këshilli nga dosjet e administruara të kandidatës së përzgjedhur sikurse edhe të ankuesit, ka gjetur se ankuesi posedon Diplomën me numër:643 të datës 05.10.2018 përmes të cilës dëshmohet se i njëjti me datë 07.09.2018 ka mbaruar studimet në Fakulteti Juridik në Universitetin "Haxhi Zeka" në Pejë duke marr titullin Baçelor i Drejtësisë, dhe po ashtu ankuesi posedon Diplomën me numër:83 të datës 14.10.2020 përmes të cilës dëshmohet se i njëjti me datë 05.10.2020 ka mbaruar studimet Master në Fakultetin Juridik në Universitetin "Haxhi Zeka" në Pejë duke marr titullin (Master) në Juridiko Penal. Po ashtu, sipas Çertifikatës së datës 24.02.2020 me shifër A.GJ.I.nr.43/2022 të lëshuar nga Administratori i Gjykatës Themelore në Gjakovë vërtetohet fakti se ankuesi ka kryer praktikën gjyqësore në kohëzgjatje prej një (1) viti dhe at nga data 25.02.2019 deri me datë 24.02.2020 në Gjykatën Themelore në Gjakovë e cila periudhë kohore njëkohësisht i llogaritet edhe përvojë e punës profesionale. Ashtu, edhe kandidatja e përzgjedhur posedon Diplomën me numër:1751/2021 të datës 31.08.2021 përmes të cilës dëshmohet se e njëjta me datë 18.06.2019 ka mbaruar studimet në Kolegjin AAB në Universitetin duke marr titullin LLB në Juridike-Juridik i Përgjithshëm, sikurse e njëjta në bazë të Kontratës së punës së datës 01.12.2021 me numër:37/2021 dëshmohet se ka lidhur marrëdhënie punë vullnetare në Këshillin Prokurorial të Kosovës nga data 01.12.2012 dhe deri në momentin e aplikimit në konkursin e lartë cekur me datë 05.09.2022 i ka pasur nëntë (9) muaj përvojë pune në këtë pozitë, ndërsa sipas vërtetimit të datës 25.08.2022 të lëshuar nga

&

dëshmohet fakti se e njëjta ka qenë e angazhuar për periudhën kohore nga data 01.10.2021 deri me datë 01.10.2021 në cilësi të praktikantes, nga rrjedh se kandidatja e përzgjedhur në momentin e aplikimit e ka përmbushur kriterin kohore prej dymbëdhjetë (12) muajsh apo një (1) viti të përvojës së punës, nga rrjedh Komisioni Përzgjedhës me rastin e përfshirjes sikurse të ankuesit dhe kandidatës së përzgjedhur në listën e ngushtë kanë vepruar në pajtueshmëri me ka vepruar në pajtim me nenin 28 paragrafin 1 nën paragrafin 1.1 dhe 1.2 të Rregullores Nr.02/2010 për Procedurat e Rekrutimit në Shërbimin Civil i cili ka përcaktuar se: "1.Anëtarët e KPSHC-së vlerësojnë aplikacionet në bazë të kriterëve në vijmë:1.1. arsimimi dhe kualifikimi profesional; 1.2 përvojën e punës" pasi që të dytë i kanë plotësuar kriteret e konkursit sa i përket përvojës së punës dhe kualifikimit, nga rrjedh se pretendim ankimor i ankuesit lidhur me përvojën e punës së kandidatës së përzgjedhur është i pabazuar.

Po ashtu, Kolegji i Këshilli ka konstatuar se në testin me shkrim për pozitën "Zyrtar Ligjor 2" të mbajtur me datë 16.09.2022 dhe i njëjti ka qenë i përpiluar në pajtueshmëri me nenin 36 të Rregullores Nr. 02/2010 për Procedurat e Rekrutimit në Shërbimin Civil, pasi që Pjesa e I-parë testit-Pjesa e Njohurive të Përgjithshme është përberë nga tre (3) ese, Pjesa e II-dytë e testit-Pjesa e Aftësive të Përgjithshme dhe të Personalitetit, është përberë nga dymbëdhjetë (12) pyetje me përgjigje të shumëfishta, si dhe Pjesa e III-tretë e testit- Pjesa e Njohurive lidhur me Vendin e Punës është përberë nga gjashtëmbëdhjetë (16) pyetje, prej tyre gjysma me përgjigje të shumëfishta dhe gjysma në formë eseje të shkurtra, ankuesi ka arritur të grumbulloi 64 pikë në testin me shkrim, ndërsa kandidatja e përzgjedhur ka arritur të grumbulloi 62 pikë në testin me shkrim si dhe gjatë analizimit të testit me shkrim të ankueses dhe të kandidatës së përzgjedhur nuk është vërejtur ndonjë parregullsi e cila mund ta ketë favorizuar respektivisht



dëmtuar ndonjërin nga kandidatët në procedurë rekrutimi dhe me rastin e ftesës për intervistim me gojë komisioni përzgjedhës ka vepruar në pajtueshmëri me dispozitat e Rregullores Nr. 02/2010 për Procedurat e Rekrutimit në Shërbimin Civil nenit 36 paragrafit 2, i cili përcakton: *“kandidatët të cilët kalojnë me sukses testin me shkrim ose arrijnë të mbledhin 50% të pikëve të përcaktuara nga KPSHC pranohen të hyjnë në testimin me gojë”*, ndërsa në bazë të përmbledhjes të vlerësimeve individuale të testit me shkrim dhe intervistës, kandidatja e përzgjedhur ka qenë kandidati me më së shumti pikë të grumbulluara gjithsejtë 69.9 pikë, ndërsa ankuesi është renditur i teti me radhë me gjithsejtë 53.4 pikë, andaj me rastin e përzgjedhjes së kandidatës së suksesshme Komisioni Përzgjedhës ka vepruar në pajtueshmëri me nenin 40 paragrafi 1 i Rregullores 02/2010, për Procedurat e Rekrutimit në Shërbimin Civil i përcakton se: *“në Shërbimi Civil emërohen kandidatët të cilët kanë arritur numrin më të madh total të pikëve në testin me shkrim dhe me gojë”*, andaj pretendimet ankimore të ankuesit se Komisioni Përzgjedhës nuk ka qenë objektiv në vlerësimin e bërë janë të pabazuara dhe të paqëndrueshme.

Kolegji për Shqyrtimin dhe Vendosjen e ankesave, nga administrimi i shkresave të lëndës të ofruara nga palët në procedurë si dhe mbi bazën e konstatimeve të dhëna si në arsyetimin e këtij vendimi, ka konstatuar se Komisioni Përzgjedhës gjatë zhvillimit të procedurave të rekrutimit për pozitën “Zyrtar Ligjor 2” në Prokurorinë Themelore në Gjakovë, ka vepruar në pajtueshmëri me të Ligjin Nr. 03/L-149 për Shërbimin Civil të Republikës së Kosovës neni 18 paragrafi 1 i cili përcakton që: *“Pranimi në Shërbimin Civil mbështetet në parimet e meritës, me shpallje publike të pozitave të lira, me transparencë të procesit, me objektivitet dhe paanësinë e komisionit testues, mos diskriminimin e kandidatëve dhe të drejtën për t’u ankuar në fund të procedurës”*, ngase nuk është vërtetuar asnjë shkelje procedurale dhe materiale sikurse pretendonte ankuesi dhe si e tillë ankesa e ankuesit është e pabazuar e cila është refuzuar si në dispozitiv të këtij vendimi.

Ndërlidhur me pretendimin ankimor të ankuesit se Këshilli Prokurorial i Kosovës nuk e ka njoftuar Këshillin lidhur me inicimin procedurës së rekrutimit për pozita udhëheqëse me qëllim të mbikëqyrjes, Kolegji i Këshillit thekson faktin se pozita e punës “Zyrtar Ligjor 2” bazuar në katalogun e vendeve të punës në shërbimin civil sikurse as me dispozitat e Ligjit Nr.03/L-149 për Shërbimin Civil të Republikës nuk hynë në kuadër të pozitave udhëheqëse, mirëpo edhe sikurse pozita e tillë të ishte pozitë udhëheqëse, Këshilli Prokurorial i Kosovës nuk do të obligohej që ta njoftonte Këshillin për një procedurë të tillë ngase Gjykata Kushtetuese e Republikës së Kosovës, me datë 20.05.2019 në rastin KO171/18 e ka shfuqizuar nën paragrafi 6 1.2 të nenit 6 të Ligjit Nr. 06/L-048 për Këshillin e Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës ku përcaktohej se: *“Për mbikëqyrjen e zbatimit të rregullave dhe parimeve të legjislacionit për shërbimin civil, Këshilli ka këto funksione themelore: 2. mbikëqyrë procedurën e përzgjedhjes dhe vendos nëse emërimet e nëpunësve civil të nivelit të lartë drejtues dhe të nivelit drejtues, janë zhvilluar në pajtim me rregullat dhe parimet e legjislacionit për shërbimin civil”*, nga rrjedh se Këshilli nuk ka mandat që të mbikëqyrë procedurën e përzgjedhjes për pozitat udhëheqëse sipas njoftimit të institucionit apo sipas detyrës zyrtare, përveçse në rastet kur ka ankesë nga palët në procedurë lidhur me procedurën e rekrutimit për pozitat në fjalë.

Po ashtu, Kolegji i Këshillit, konstaton se Komisioni për Zgjidhjen e Kontesteve dhe Ankesave i Këshillit Prokurorial të Kosovës, me rastin e nxjerrjes së Vendimit numër KA.Nr.34/202219 të datës 07.11.2022, përmes të cilit e ka refuzuar ankesën e ankuesit të datës 26.10.2022, ndërsa

e kanë lënë në fuqi Njoftimin e datës 06.10.2022 për përzgjedhjen përfundimtare, ka vepruar në pajtim me dispozitat e Ligjit Nr. 03/L-149 për Shërbimin Civil të Republikës së Kosovës, Ligjit Nr. 05/L-031 për Procedurën e Përgjithshme Administrative si dhe Rregulloren Nr. 05/2011 për Procedurat e Zgjidhjes së Kontesteve dhe Ankesave, pasi që ka vërtetuar drejtë gjendjen faktike dhe bazën juridike.

Andaj, pas analizimit dhe vlerësimit të të gjitha shkresave të lëndës si dhe duke u bazuar nën 6 paragrafi 1, nën paragrafi 1.1 si dhe nën 18 paragrafi 1 nën paragrafi 1.1 të Ligjit Nr.06/L-048 për Këshillin e Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës si dhe nën 132 paragrafi 2 të Ligjit Nr. 05/L-031 për Procedurën e Përgjithshme Administrative, Kolegji i Këshillit vendosi si në dispozitiv të këtij Vendimi.

Vendimi hyn në fuqi në ditën e nënshkrimit nga Kryetari i Kolegjit.

Këshillë juridike: Kundër vendimit të Këshillit, pala e pakënaqur e cila pretendon se vendimi i Këshillit nuk është i ligjshëm mund të iniciojë konflikt administrativ në Gjykatën Themelore në Prishtinë-Departamenti për Çështje Administrative, brenda afatit prej tridhjetë (30) ditësh, nga dita në të cilën i është dorëzuar vendimi. Inicimi i konfliktit administrativ nuk e ndalon ekzekutimin e këtij vendimi.

KËSHILLI I PAVARUR MBIKËQYRËS PËR SHËRBIMIN CIVIL TË KOSOVËS

Lënda me numër A.nr.1103/2022

Flakron GASHI

Zyrtar i Lartë për Bashkëpunim Profesional

Eshref SHABANI

Kryetar i Kolegjit

Vendimi i dërrrohet:

- Ankuesit
- Drejtorit të Përgjithshëm të Sekretarit të Këshillit Prokurorial të Kosovës
- Udhëheqësit të Burimeve Njerëzore në Sekretariatit të Këshillit Prokurorial të Kosovës, dhe
- Arkivit të KPMSHCK-së.